

UNIVERSITETI I PRISHTINES-“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI JURIDIK
DREJTIMI KUSHTETUES- ADMINISTRATIV
STUDIMET POSTDIPLOMIKE- MASTER



PUNIM I DIPLOMËS MASTER

TEMA:
“ SFIDAT NË MBROJTJENE TË DREJTAVE TË FËMIJEVE NË KOSOVËS”

Mentori:
Prof.ass. Dr.Flamur Hyseni

Kandidatja:
Arbesa Musliu

Prishtinë, Dhjetor 2024

ABSTRAKTI

Qëllimi i studimit të kësaj teme është sepse siç dihet, në Kosovë nuk e kemi një gjendje të mirë të fëmijëve. Kemi një përqindje të lartë të varfërisë së fëmijëve, ku shume prej tyre jetojnë në varfëri dhe kemi një përdorim të lartë të shkallës së dhunës. Dhe përmes këtij punimi pretendoj te arrij te mësoj sfidat që përballet Kosova për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si pjesë delikate e shoqërisë tone. Duke pasur fakte se fëmijët në shoqërinë kosovare janë kategoria të cilës më së shumti u cënohen të drejtat, përmes këtij punimi kam bërë përpjekje të shpjegoj sfidat cilat janë si dhe mbrojtjen ligjore, e cila parashihet të ju ofrohet dhe është e rregulluar me Kushtetutën, dhe sipas te drejtes pozitive te vendit tonë dhe përmes mekanizmave të tjerë të ndryshëm.

Pos sfidave dhe mbrojtjes ligjore, kam bërë një vështrim mbi një sërë organizatash dhe konventa vendore dhe ndërkombëtare që kanë në fokus fëmijët dhe mbrojtjen e tyre.

Me anë të këtij punimi kam shtjelluar se fëmijët në Kosovë janë kategoria më e rrezikuar dhe mu për këtë duhet të ndërmerren masa institucionale për mbrojtje më të theksuar, respektivisht duhet aprovuar Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Punimi është rezultat i një pune kërkimore të literaturës përkatëse në aspektin shkencor si dhe të legjislacionit ndërkombëtar dhe kombëtar.

Fjalë kyçe: Sfidat tek të drejtat e fëmijëve, Kushtetuta e Kosovës, Konventat për te drejta e fëmijëve, Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.